



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr 80 Datë 30.11.2022

“Për dhënien me qira të sipërfaqes prej 190 m2, me afat 1 vjeçar, pjesë nga sipërfaqja e përgjithshme e pasurisë nr 209/2, Zk nr 2236, e llojit “Pa Fryt” ndodhur në fshatin Kosmaç, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës.”

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, në VKM nr. 246 dt 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, datë 28.01.2008 të Këshillit të ministrave, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike të shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, kapitulli I, pika 2, pika 5, shkronja “a”, pika 6, shkronja “a”, kapitulli III, shkronja “c”, të VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, pika 4, pika 34, të Udhëzimit nr 13, datë 18.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014”, (sipërcituar), Projekt Vendimit nr 09, datë 31.10.2022, paraqitur nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritimit, pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak.

VENDOSI :

1. Miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes prej 190 m2, me afat 1 vjeçar, pjesë e pasurisë nr 209/2, ndodhur në Zk nr 2236, fshati Kosmaç, Bashkia Vau Dejës.
2. Tarifa e qirasë vjetore të jetë 19 000 lekë në vit, bazuar në Udhëzimin nr 13, datë 26, 04. 2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritimit
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes Publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mark Bisha

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 19 _____ vota

Vota pro 19 _____

Vota kundër - _____

Vota abstenim - _____

Zbardhur me datë 05.12.2022

Adresa: “Rruga Qafa e Gurit” Vau Dejes, Telefon/Faks 00355 2612 0006 , e-mail: info@vaudejes.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 6832/1 Prot

Dt. 22.12.2022



Nr. 896/1 Prot.

Shkodër, më 16.12.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 80, datë 30.11.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të VKM nr 68, datë 28.01.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës", të ndryshuar, të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, Kapitulli I, pika 2, pika 5, shkronja "a", pika 6, shkronja "a", të Udhëzimit nr. 13, date 18.04.2018 "Për zbatim të VKM nr. 54, datë 5.02.2014", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 6175 prot., datë 02.11.2022 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 28.10.2022", shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 80, datë 30.11.2022 "Për dhënien me qira të sipërfaqes prej 190 m², me afat 1 vjeçar, pjesë nga sipërfaqja e përgjithshme e pasurisë nr. 209/2, ZK 2236. lloji "pa fryt", ndodhur në fshatin Kosmaç, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës"*.

Per sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANGONI

